



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 121, datë 26.08.2025**

**PËR  
MIRATIMIN E ZËVENDËSIMIT TË DEPOZITARIT “BANKA E PARË E  
INVESTIMEVE, ALBANIA” SH.A., ME DEPOZITARIN “BANKA CREDINS” SH.A.,  
PËR FONDET E INVESTIMIT “ABI FLEX EURO” DHE “ABI FLEX USD”, TË  
ADMINISTRUARA NGA “ABI INVEST” SH.A., SHOQËRI ADMINISTRUESE E  
SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE.**

Në zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 47, të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe Rregullores nr. 189, datë 16.12.2020 “Mbi pezullimin, mbylljen, marrjen në administrim dhe likuidimin e shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, si dhe mbi zëvendësimin e shoqërive administruese të fondeve dhe depozitarëve”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e zëvendësimit të depozitarit “Banka e Parë e Investimeve, Albania” sh.a., me depozitarin “Banka Credins” sh.a., për fondet e investimit “ABI FLEX EURO” dhe “ABI FLEX USD”, të administruara nga “ABI Invest” sh.a., shoqëri administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR  
Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Mimoza KAÇI**